



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:093644

Datë: 16.09.2019

Numri i dokumentit: 00513681

P.nr.48/2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtaret Beqir Halili-Kryetar i trupit gjykues dhe gjyqetareve Rrahman Beqiri dhe Florije Syka-anëtar te trupit gjykues, me procesmbajtësen Qendresa Tahiri, në lenden penale kundër te akuzuarit M.B për shkak te veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës te Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë PP.nr.110/2011 të datës 26.09.2011, te cilën e përfaqëson Prokurori Ismet Ujkani, pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor me datën 09.09.2019, ndërsa me datën 11.09.2019ne prani te te akuzuarit M.B e në mungesë të prokurorit Ismet Ujkani dhe mbrojtëses se tij av. F.B e shpalli, kurse me datën 12.09.2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.B me nofkën “..”, i biri i K. dhe M. e gjinisë rr., i lindur me ... ne ..., ku edhe jeton rr. “...”pn, shqipetar, shtetas i Republikës se Kosoves, i pa pune, i pamartuar, ka te kryer shkollen e mesme teknike-tekstil, i gjendjes se varfër ekonomike, i njohur edhe me pare si kryers i vepreve te ndryshme penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Me datën 24.08.2011 rreth orës 22:00 ne rr. “...” ne ... afër parkut ne vendin ku janë vendosur lojrat e fëmijëve “hulaqat” me dashje ka tentuar qe ta privoj nga jeta te dëmtuarin A.H ne ate menyre qe pas nje zenke verbale me qe ia ka drejtuar te dëmtuarit nje drite te shkrepes e i dëmtuari i ka thene “nale se po me pengon” e pastaj i pandehuri e ka sulmuar te dëmtuarin duke e goitur pese here ne trup e ate tri here ne shpine e dy here ne dorën e majte, ku i ka shkaktuar nje plage shpuese-prerese ne regjionin torako-dorezal majtas me gjatësi rreth 0.5-1 cm dhe thellësi qe nuk e cenon hapsiren pleurale, nje plage shpuese-prerese ne regjionin torako-dorezal majtasafër shtyllës kurrizore me gjatësi 0.5-1cmdhe thellësi qe nuk e cenon hapsiren pleurale, nje plage shpuese-prerese ne regjionin lumbal majtas me gjatësi rreth 0.5cm dhe 1-2cm thellësi, nje plage shpuese-prerese ne regjionin e shuplakës se dorës se majte-pjeses palmare me gjatësi rreth 2-3cm dhe 1-2 cm thellësi dhe nje plage prerëse-shpuese ne regjinon e shuplakës se dorës se majte-pjeses dorezale me gjatësi reeth 1-2cm dhe thellësi 1-2cm.

Me këtë ka kryer veprën penale **Vrasje ne tentative nga neni146 lidhur me nenin 20 te KPK-se**

Në bazë të dispozitave të nenit 34, 38, 60,64, 66. 67, par.1 pika 2, 73 te KPK-së dhe nenit 365 e 450 par. 2 dhe pika 2.6 të KPP-së.

:

G J Y K O N

ME DENIM ME BURG, ne kohëzgjatje prej nje (1) viti.

Në këtë dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dates 31.08.2011 e deri me date 22.11.2011 dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak prej 22.11.2011 deri 22.12.2011.

Te akuzuarit i konfiskohet mjete I kryerjes se vepres penale-thika.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te shpenzimeve te procedurës penale e ne emër te paushallit gjyqësor ta paguaj shumen prej njëqind (100) Euro dhe shumen prej pesedhjetë (50) Euro ne emër te fondit per kompensimin e viktimave.

Te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se formës se prere te këtij aktgjykimi nen kërcënimin e ekzekutimit te dhunshëm.

Kërkesa pasurore juridike nuk ka pasur.

A r s y e t i m

I. AKTAKUZA

Prokuroria Publike e Qarkut ne Mitrovicë, ka ngritur aktakuzë PP.nr.110/2011 të datës 26.09.2011 kundër te akuzuarit M.B per shkak te veprës penale Vrasje ne tentative nga neni 146 e lidhur me nenin 20 te KPK-se.

Prokurori i PTH-së në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, Ismet Ujkani, në fjalën e tij përfundimtare deklaroj: se mbes pran aktakuzës sepse me provat e nxjerra e atë deklarata e të dëmtuarit A.H dhe dëshmitarit A.Sh su dhe provat materiale Vertetimi mbi konfiskimin e sendeve-thikes nga i pandehuri dhe dokumentacioni mjekësor ne emër te te dëmtuarit rrjedh se i pandehuri ka kryer veprën penale per te cilën ngarkohet sipas aktakuzës. Mbrojtja qe i pandehuri e ka dhene gjate shqyrtimit gjyqësor eshte e pabaze dhe e paargumentuar e qe demantohet nga deklarimi i te dëmtuarit A.H dhe dëshmitarit A.Sh andaj edhe gjykata duhet ta hudh posht si te pabaze. Duke e pasur parasysh numrin e goditjeve dmth faktin se i dëmtuari eshte goditur 5 here ne trup me thik nga i pandehuri, jep per tu kuptuar se dashja e tij ka qene qe ta privoj nga jeta te dëmtuarin. Gjykatës i propozoje qe te pamdehurin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj me denim sipas ligjit duke pas parasysh te gjitha rrethanat e parapara me KPRK ne menyre qe dënimi i shqiptuar te jete adekuat sipas ligjit, poashtu ka kërkuar qe te pandehurit ti konfiskohet mjete i kryerjes se veprës se veprës penale-thika.

II. MBROJTJA

1). Në fjalën përfundimtare mbrojtësja e te akuzuarit M.B Av. F.B në fjalën e saj përfundimtare te dorëzuar me shkrim deklaroj: nga provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor te dates 05.09.2019 nuk u vërtetua ne menyre bindëse se i mbrojturi im ka kryer veprën penale per te cilën ngarkohet sipas aktakuzës. I dëmtuari A.H kur eshte degjuar ne cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se “ me pare nuk e ka njohur te pandehurin” si dhe kur eshte pyetur nga mbrojtësja e te akuzuarit “ ju po thoni qe ka qene terr, a ka pas mundësi me i identifiku personat qe te kane godit qofte me thik qofte me shuplak”, i dëmtuari eshte përgjigjur “ jo nuk e kam njohur kete djal por tjetër kush e ka njohur”, e ne pyetjen “kur thoni kete djal per kënd e keni fjalën” i dëmtuari eshte përgjigjur “M.”. Pra nga deshmitari- te demtuarit nuk vërtetohet se kete te demtuar e ka goditur me thik tani i akuzuari M.B pasi qe vet ky dëshmitar ne deklarimete tij qofte ne gjykate qofte ne polici ka thene s

epersoni që eka therr me thik nuk ka mundur ta identifikoj , por kete e ka identifikuar nje person tjetër.

Ne shqyrtimin gjyqësor te dates 05.09.2019 eshte dëgjuar edhe dëshmitari A.Sh i cili ka dhene deklarate kontradiktore me deklaratën e dhene ne polici me datën 24.08.2011 pasi qe ne deklaratën e dhene ne polici kur eshte pyetur “a e keni pa ndonjë person te godiste A.?” , dëshmitari eshte përgjigjur “ kur kam mbërri une kish marr fund , poashtu ne kete deklarate ka thene se “ me A. kam qene me herët se sa ka ndodh dhe eshte nda me te dhe kur eshte vonuar ka thene qe ka shkuar me kqyr se qka u be dhe kur ka mberri ka pa A. te shtrire ne toke dhe ishte kan i therrur me thik ne dore dhe ne trup” mdersa ne shqyrtimi gjyqësor te dates 05.09.20149 ka deklaruar se ka qene se bashku me A. gjate gjithë kohës sa ka ndodh rasti, ne fillim ka deklaruar se M. e ka njohur pas këtij rasti,, ndërsa me vone gjate deklarimit te tij ne kete shqyrtim ka deklaruar se M. e ka njohur si figure edhe përpara por nuk ka pasur kontakt me te. si dhe kur eshte pyetur “ a e keni pasur rastin me te freskët ne kohen kur ka dhene deklarate ne polici apo tani pas 8 viteve?” dëshmitari pergjigjet “ ne ato momente une kam deklaruar ashtu dhe sa e di une vetëm ne emergjence mi ka marr te dhënat dhe nuk me kujtohet se kam dhene deklarate ne polici. Ky dëshmitar poashtu eshte pyetur “ne vend te ngjarjes a i ke pare ndonjë mjey te rrezikshëm ne dore M.” dëshmitari eshte pergjigjut se “ ka qene terr, ne ato momente ka pas diqka ne dore ndoshta thik.

Pra nga deklaratimet e te dëmtuarit A.H dhe dëshmitarit A.Sh nuk ka mundur te vërtetohet bindshëm se goditjet me thik qe i ka marr i dëmtuari A.H sipas raporteve mjekesore te cilat gjenden ne shkreat e lendes nga kush i ka marrur. Ndërsa sa i përket deklarimit te vete te akuzuarit te dhene en shqyrtimin gjyqësor se i njëjti ditën kritike nuk ka pasur thik dhe nuk e ka goditur te dëmtuarin e me qe ne polici ka deklaruar se ka pasur thik dhe gjate përlshjes me te dëmtuarin ka pasur mundësi ta godas tani te dëmtuarin, i akuzuari eshte përgjigjur se ne ate kohe kur ka dhene deklarate ne polici ka qene ne stresin e policeve dhe iu eshte dashur qe te pranon diqka qe nuk ka bere dhe ne shqyrtimin gjyqësor thotë se e deklarone te verteten. Pra me asnjë prove te vetme te administruar konsiderojmë se nuk eshte vërtetuar se i mbrojturi im ka kryer veprën peale te përshkruar ne dispozitiv te aktakuzës, dhe konsiderojmë se prokurori me asnjë prove relevante nuk ka vërtetuar përtej dyshimit te bazuar ekzistimin e veprës penale Vrasje ne tentative.

Parimi “in dubio pro reo” e obligon gjykatën qe te beje vlerësimin e nderjgegjishem te secilës prove veq e veq e te gjithave se bashku dhe te jap vlerësimin per besueshmërinë e provave te kundërta, ne menyre qe ne baze te atij vlerësimi te nxjerr përfundimin mbi provueshmërinë ose mos provueshmërinë e fakteve vendimtare te daktuara.

Permbjedhja e provave qe janë prezentuar ne shqyrtimet e mbajtura nuk përmbajnë hollesitn, saktësinë, dhe besueshmërinë përtej dyshimit te arsyeshëm te cilat do te tregonin se ekziston arsye e plote se M.B ka kryer veprën penale sipas dispozitivit te aktakuzës. Gjithashtu i propozojmë gjykatës qe te kete parasysh faktin se ne kete rast i mbrojturi im eshte dëmtuar pasi qe me shume se 8 vite ka mbetur ne pritje te vendosjes ne kete lend, ka humbur shume mundësi per te dale jashtë shtetit per te punuar pasi qe ne familjen e tij askush nuk eshte i punësuar dhe varen vetëm nga pensioni prej 75 euro qe i merr prindi i tij i semure. I ka propozuar gjykatës qe pas vlerësimit te provave te merr aktgjykim lirues.

2). I akuzuari M.B në mbrojtjen e tij gjate shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike kam dal me shëtiti pasi qe kam jetuar te parku, kam dal te parku te hulajat dhe ne ate moment kane qene nje grup dhe kam mëndu se ka qene ndonjë shok i imi dhe ua kam drejtuar nje shkrep me drite ne drejtim te tyre, e kam shikuar se ata nuk janë shokët e mi, pasi e kam largua dritën ata me janë afruar dhe ja kane nis me ma hi. Me kane rrezuar per toke, e di qe diqka kam kap prej toke dhe ia kam hi me diqka per me pas vetëmbrojtje dhe mandej une nuk

di kursesi kurgjo. Kam shkuar ne shtëpi dhe te nesërmen kane ardh policia me kane detyruar per me pranu. Kam pas shume stres se me thonin duhet me gjet thikën dhe une e kam pas nje thik te shtëpia dhe une garantoj se me ate thik une nuk kam kryer kurfar vepre. Mua me kan rreh policia dhe per kete arsye e kam gjet nje thik dhe e kam dërguar ne polici. Une mendoj se ai ka pas problem me tjetër kënd. Nga ngjarja kane kaluar afër 7-8 vite dhe ngjarjen e kam me te sakte tash. A.H nuk e kam njohur as përpara as pasi ka ndodhur rasti deri tani ne gjykate, ndërsa A.Sh e kam njohur si figure.

Ndërsa ne procesverbalin mbi intervistimin e te deshuarit te dhene ne polici me dt 31.08.2011 i akuzuari M.B ka deklaruar se me datën 24.08.2011 kam qene afër parkut, une ia qita nje djalit qe isha me te dritën e shkrebzes me qellim qe te qohej e ne te shkonim aty, kur nje person te cilit nuk ia di emrin me tha “qa po ma qet dritën a e din qe me tu qu e me ta dhez shuplak syt xhixha ti qes”. Une nuk fola hiq dhe veq eca me shokun tem, ai djali qe me foli kështu me kapi per dore dhe me kthej prej vetit dhe ma dhezi shuplak, tani mua me hupi kontrolla dhe nuk e di se qa u bo masanena. Une e nxjerra briskun qe e kisha ne xhepin e djathte dhe tu u shtye kështu ai me shtini perfundri dhe une nuk kisha tjetër rrugëdalje, e di qe nje here ia kam msho ne dore e aty qka sbo vaki nashta ia kam hi edhe me shume here por nuk e di. Masi e kam godit i kam ra pishman dhe jam shkue ne park dhe kam nejt pak dhe jam ec ne shtëpi. Kur e kam therr personin kam qene i gerrbavt dhe ne këmbët e mija. Briskun e kam gjet ne stadium te hulaqat tri dite para se te ndodhte rasti dhe thash ta mbaj me vete . ai brisk ndodhet ne dhomën time, ne dukje eshte dorezen e ka te zeze dhe e ka nje pulle per tu qelur e cila nuk i punon

III. STANDARDET JURIDIKE

1.E drejta në mbrojtje: Gjykata konstaton se i akuzuarit ka pas mbrojtës dhe e ka shfrytëzuar mundësinë që të propozoj dhe të nxjerr prova. Të gjitha provat të cilat gjykata i ka vlerësuar janë demonstruar në shqyrtimin gjyqësor. Gjithashtu gjykata i ka ofruar mundësi të akuzuarit që këto prova t'i shqyrtoj dhe ti kundërshtoj. Gjithashtu gjykata i ka ofruar mundësi mbrojtësit që gjate shqyrtimit gjyqësor të jap vërejtje dhe të komentoj vendimet e procedurës paraprake dhe të tregoj në parregullsi në aspektin e mbledhjes së provave në procedurën paraprake. Këto kundërshtime gjykata i ka vlerësuar në kontekstin e provave të demonstruara gjate shqyrtimit gjyqësor .

2.Shyrtimi dhe vlerësimi i provave: Gjykata ka pas parasysh dhe i ka vlerësuar të gjitha provat e aktakuzës dhe mbrojtjes dhe me aktgjykim do ti arsyetoi vetëm ato prova të cilat kanë të bëjnë me faktet vendimtare dhe do të nxjerr konkluzione vetëm për ato fakte te cilat janë thelbësore dhe të vlefshme për aktgjykim.

3.Standardi i të provuarit: Praktika gjyqësore për aktgjykimin fajësues e ka definuar si standard “dyshim i bazuar mirë” sipas kuptimit të përgjithshëm dyshimi i bazuar mirë nënkupton posedimin e provave të pranueshme që do të binte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri.

IV.DISPOZITAT RELEVANTE MATERIALE

1. Për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, shprehimisht parashihet:

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me së paku pesë vjet burgim.

Ndërsa neni 20 i Kodit Penal të Kosovës për veprën penale të mbetur në tentativë thotë:

(1) Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.

(2) Tentativa për kryerjen e një vepre penale të dënueshme me së paku tre vjet burgim, dënohet, kurse lidhur me veprat e tjera penale tentativa dënohet vetëm nëse ligji e parasheh shprehimisht këtë.

(3) Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet më butë se sa kryerësi, në pajtim me nenin 65(2) të këtij Kodi.

V. PROVAT

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë dëgjuar dëshmitari- i dëmtuari A.H, dëshmitari A.Sh, dhe janë admiruar këto prova materiale: Vertetimi mbi konfiskimin e sendeve- thikës nga i pandehuri i dt.24.08.2011. Raporti mjekësor te QKMF ne ... te dt.24.08.2011 ne emër te te dëmtuarit. Fleteleshimin e QKUK- Klinika e kirurgjisë- Kirurgjia torakale nr i amzës ... ne emër te te dëmtuarit. Memorandumi zyrtar te policisë se Kosoves mbi verifikimin e dosjeve kriminale te te pandehurit. Vështrohet fotoalbumi i hetimit.

Dëshmitari- i dëmtuari A.H në shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me datën 05.09.2019 ka deklaruar: se ditën kritike kam qene ne qytet me A.Sh , dolëm te parku dhe aty ka ndodh ngjarja. Jemi rreh njeri me tjetrin, ai e ka nxjerr thikën dhe me ka ra tri here ne shpine dhe ne dorën e majte te gishti i madh. M. ka qene me 3-4 veta nuk me kujtohet sakte, ndërsa une kam qene me A.Sh i cili me ka kap per krahu dhe me tha hajde ecim dhe aty i akuzuarime ka mshu ne shpine, une kam qene ne kemb, kurse te pandehurin nuk ek kam pare pasi qe ka qene prapa meje. Kur jam kthij jam mundu me ia marr thikën por jam prere ne dorën e majte.. kam qëndruar nje jave ne spital ne.... Me te pandehurin nuk jam njohur me pare, por ate e kan identifikuar personat e tjerë. Thikën nuk e kam pare qfare përmasash ka pasur, nuk kam mujt me identifiku.

Dëshmitari A.Sh në shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me datën 05.09.2019 ka deklaruar: se ditën kritike kam qene se bashku me A. dhe M. ia ka qit nje drite nuk e di se qfare dhe ne ate moment ka qene nje konflikt ne mes te tyre dhe une jam mundu me i nda, ne ate moment une e kam marre A. dhe jemi larguar dhe ka ardh nga mrapa M. dhe i ka ra me thik. A. e kam marr e kam afriu te asfalti, e kemi gjet nje kerr dhe e kemi dergu ne Emergjence ne M.i ka qene edhe me dikend tjetër qe nuk e kam njohur. Deklarata e sakte eshte ajo te cilën e dhash sot. Sa e di une policia vetëm ne emergjence mi ka marre te dhënat, nuk me kujtohet qe kam dhene deklarte ne polici. M. e kam njohur si figure edhe me pare nga shkolla, ndërsa pas rastit e kam njohur edhe me mire. ka qene terr, ne ato momente ka pas diqka ne dore ndoshta edhe thik, ne kemi ecur dhe ai ka ardhur pas neve dhe e ka goditur A.. Me mua dhe A. ka qene edhe nje person tjetër, por nuk e di se kush ka qene pasi qe ai person nuk ka pasur shoqëri me neve.

Nga Vertetimi mbi konfiskimin e sendeve- thikës nga i pandehuri i dt.24.08.2011 vertetohet se policia nga i pandehuri ka konfiskuar nje brisk ngjyre te zeze me gjatësi 14.5 cm derisa tehu i saj eshte 6.5 cm.

Nga Raporti mjekësor te QKMF ne ... te dt.24.08.2011 ne emër te te dëmtuarit vërtetohet se është pranuar ne Qendren Emergjente per shkak te therrjes me mjet te mprehte ku janë konstatuar tri plage prerëse-shpuese ne shpine dhe prerje ne shuplaken e majte dhe pas egzaminimit është trajtuar dhe është udhëzuar per ne Qendren emergjente ne

Nga Fleteleshimin e QKUK- Klinika e kirurgjisë- Kirurgjia torakale nr i amzës ... ne emër te te dëmtuarit vërtetohet se i dëmtuari është pranuar per shkak te lëndimit te marre nga mjete i mprhte –thika dhe se i dëmtuari ka pësuar plage shpuese-prerese.

Nga Memorandumi zyrtar te policisë se Kosoves mbi verifikimin e dosjeve kriminale te te pandehurit vërtetohet se i pandehuri është i njohur si kryeri i veprave penale

Nga fotoalbumi i hetimit shihet i dëmtuari A.H me plagët qe i ka marre dhe brisku i cili është konfiskuar nga i pandehuri.

VI. ANALIZA E PROVAVE

Këto prova gjykata ne baze te nenit 361 te KPP-së, me ndërgjegje i vlerësoi një nga një dhe ne lidhje me prova tjera dhe në baze të vlerësimit të tillë vërtetoje këtë gjendje faktike:

Se me datën 24.08.2011 rreth orës 22:00 ne rr. “...” ne ... afër parkut ne vendin ku janë vendosur lojrat e fëmijëve “hulaqat” me dashje ka tentuar qe ta privoj nga jeta te dëmtuarin A.H ne ate menyre qe pas nje zenke verbale me qe ia ka drejtuar te dëmtuarit nje drite te shkrepes e i dëmtuari i ka thene “nale se po me pengon” e pastaj i pandehuri e ka sulmuar te dëmtuarin duke e goitur pese here ne trup e ate tri here ne shpine e dy here ne dorën e majte, ku i ka shkaktuar nje plage shpuese-prerese ne regjionin torako-dorezal majtas me gjatësi rreth 0.5-1 cm dhe thellësi qe nuk e cenon hapsiren pleurale, nje plage shpuese-prerese ne regjionin torako-dorezal majtasafër shtyllës kurrizore me gjatësi 0.5-1cmdhe thellësi qe nuk e cenon hapsiren pleurale, nje plage shpuese-prerese ne regjionin lumbal majtas me gjatësi rreth 0.5cm dhe 1-2cm thellësi, nje plage shpuese-prerese ne regjionin e shuplakës se dorës se majte-pjeses palmare me gjatësi rreth 2-3cm dhe 1-2 cm thellësi dhe nje plage prerëse-shpuese ne regjionin e shuplakës se dorës se majte-pjeses dorezale me gjatësi reeth 1-2cm dhe thellësi 1-2cm.

Faktet jo kontestuese

- Nuk është kontestues fakti se ai akuzuari M.B ditën kritike ne rr. “...” ne ... afër parkut ne vendin ku janë vendosur lojrat e fëmijëve “hulaqat” e ka goditur te dëmtuarin A.H tri here ne shpine e dy here ne dorën e majte, e qe vertetphet nga Raporti mjekësor te QKMF ne ... te dt.24.08.2011 ne emër te te dëmtuarit A.H.

- Nuk është kontestues fakti se i akuzuari M.B ditën kritike ia ka drejtuar nje drite te shkrepes ne drejtim te te dëmtuarit A.H, e qe vërtetohet nga deklarata e vet te akuzuarit M.B, te dëmtuarit A.H dhe deklarata e dëshmitarit A.Sh.

-Nuk është kontestues fakti se ne shtëpinë e te pandehurit është gjetur dhe është konfiskuar nje brisk ngjyre e zeze me gjatësi 14.5 cm derisa tehu i saj është 6.5 cm, e qe vërtetohet nga Vertetimi mbi konfiskimin e sendeve- thikës nga i pandehuri i dt.24.08.2011

Faktet kontestuese

- Fakt kontestues është fakti se i akuzuari me veprimin e ndërmarr a ka dashur ta privoj nga jeta të dëmtuarin siç pretendon aktakuza (*me dashje ka tentuar që ta privoj nga jeta te dëmtuarin A.H*), apo që i akuzuari nuk ka tentuar që ta privoj nga jeta te dëmtuarin A.H siç pretendon mbrojtja (*Me kane rrezuar per toke, e di qe diqka kam kap prej toke dhe ia kam hi me diqka per me pas vetëmbrojtje dhe mandej une nuk di kursesi kurgjo. Kam shkuar ne shtëpi dhe te nesërmen kane ardh policia me kane detyruar per me pranu. Kam pas shume stres se me thonin duhet me gjet thikën dhe une e kam pas nje thik te shtëpia dhe une garantoj se me ate thik une nuk kam kryer kurfar vepre. Mua me kan rreh policia dhe per kete arsye e kam gjet nje thik dhe e kam dërguar ne polici).*

Trupi gjykues vërteton se pretendimi i mbrojtjes nga ana e te akuzuarit nuk qëndron pasi që gjendja faktike e përshkruar ne dispozitave te aktakuzes perputhet edhe me provat që gjenden ne shkresat e lendes. Poashtu gjykata i vleresoi deklaratat e te akuzuarit dhe vërtetoi se deklarata e tij e dhëna ne polici dhe deklarata e dhëne gjate shqyrtimit gjyqësor janë ne kundërshtim njëra me tjetrën.

Mospërputhjet e deklaratave te dhëna ne polici dhe gjate shqyrtimit gjyqësor:

I akuzuari **M.B** gjate shqyrtimit gjyqësor te mbajtur me datën 05.09.2019 ne mes tjerash ka deklaruar: *“kam dal te parku te hulajat dhe ne ate moment kane qene nje grup dhe kam mëndu se ka qene ndonjë shok i imi dhe ua kam drejtuar nje shkrep me drite ne drejtim te tyre, e kam shikuar se ata nuk janë shokët e mi, pasi e kam largua dritën ata me janë afruar dhe ja kane nis me ma hi. Me kane rrezuar per toke, e di qe diqka kam kap prej toke dhe ia kam hi me diqka per me pas vetëmbrojtje dhe mandej une nuk di kursesi kurgjo. Kam shkuar ne shtëpi dhe te nesërmen kane ardh policia me kane detyruar per me pranu. Kam pas shume stres se me thonin duhet me gjet thikën dhe une e kam pas nje thik te shtëpia dhe une garantoj se me ate thik une nuk kam kryer kurfar vepre. Mua me kan rreh policia dhe per kete arsye e kam gjet nje thik dhe e kam dërguar ne polici. Une mendoj se ai ka pas problem me tjetër kënd.*

Ndërsa ne procesverbalin mbi intervistimin e te deshuarit te dhene ne polici me dt 31.08.2011 i akuzuari M.B ka deklaruar *“ une ia qita nje djalit qe isha me te dritën e shkrebzes me qellim qe te qohej e ne te shkonim aty, kur nje person te cilit nuk ia di emrin me tha “qa po ma qet dritën a e din qe me tu qu e me ta dhez shuplak syt xhixha ti qes”. Une nuk fola hiq dhe veq eca me shokun tem, ai djali qe me foli kështu me kapi per dore dhe me kthej prej vetit dhe ma dhezi shuplak, tani mua me hupi kontrolla dhe nuk e di se qa u bo masanena. Une e nxjerra briskun qe e kisha ne xhepin e djathte dhe tu u shtye kështu ai me shtini perfundri dhe une nuk kisha tjetër rrugëdalje, e di qe nje here ia kam msho ne dore e aty qka sbo vaki nashta ia kam hi edhe me shume here por nuk e di.*

Kunderthenjet ne mes te këtyre deklaratave qëndrojnë se ne polici i akuzuari ka deklaruar se e ka nxjerrur thikën nga gjepi i tij (te cilin e ka gjetur tri fite para se te ndodhte rasti) dhe tu u shtye kështu ai me shtini perfundri dhe une nuk kisha tjetër rrugëdalje, e di qe nje here ia kam msho ne dore e aty qka sbo vaki nashta ia kam hi edhe me shume here por nuk e di, ndersa ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se kam kap prej toke dhe ia kam hi me diqka per me pas vetëmbrojtje, ndërsa thiken pohon se nen stresin dhe presionin e policeve ua ka prezentuar nje thik te cilën e ka pasur te shtëpia e tij, e per te cilën garanton se me te nuk ka kryer kurfar vepre penale.

Trupi gjykues iu dha besim deklaratës te cilën i akuzuari e ka dhene ne polici pasi që ajo dekarat përputhet edhe me provat tjera materiale siq janë: Vertetimi mbi konfiskimin e sendeve- thikës nga i pandehuri i dt.24.08.2011. Raporti mjekësor te QKMF ne ... te

dt.24.08.2011 ne emër te te dëmtuarit. Fleteleshimin e QKUK- Klinika e kirurgjisë- Kirurgjia torakale nr i amzës ... ne emër te te dëmtuarit. Memorandumi zyrtar te policisë se Kosoves mbi verifikimin e dosjeve kriminale te te pandehurit, fotoalbumi i hetimit, si dhe deklarata e te dëmtuarit A.H dhe e dëshmitarit A.Sh te dhëna ne shqyrtimin gjyqësor prane kësaj gjykate me datën 05.09.2019.

Trupi gjykues vërtetoi se nuk qëndron pretendimi i mbrojtëses se të akuzuarit Av. F.B se me asnjë prove te vetme te administruar konsiderojmë se nuk eshte vërtetuar se i mbrojturi im ka kryer veprën penale te përshkruar ne dispozitiv te aktakuzës, dhe konsiderojmë se prokurori me asnjë prove relevante nuk ka vërtetuar përtej dyshimit te bazuar ekzistimin e veprës penale Vrasje ne tentative.

VII. MATJA E DËNIMIT

Për veprën penale Vrasje nga neni 146 të KPK-së, parashihet dënim me së paku pesë vjet burgim.

Meqenese vepra penale ka mbetur ne tentativ nga neni 20 te KPK-se, kurse ne paragrafin 3 taksativisht shkruan: personi qe tenton te kryej vepër penale dënohet me bute sesa kryersi ne pajtim me nenin 65 (2) te këtij kodi.

Gjykata te akuzuarit M.B për veprën penale Vrasje ne tentative nga neni 146 i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej nje (1) viti.

Gjykata duke u bazuar ne dispozitat e nenit 64 par.1 te KPK-se te akuzuarit i ka caktuar dënimin ne kohëzgjatje prej nje (1) viti brenda kufijeve te parapare me ligj duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësise penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, rrethanat e tij personale dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale, dhe pas vlerësimit me ndërjegje te këtyre rrethanave gjeti këto:

Rrethanat lehtësuese:

Gjykata për të akuzuarin gjeti këto rrethana lehtësues: është sjellë mirë pas rastit-konfliktit, por edhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, janë pajtuar me të dëmtuarin, se kane kaluar me tepër se tete vite prej momentit te kryerjes se kësaj vepre, se ne kohen e kryerjes se veprës penale ka qene i moshës se re (19 vjeqar).

Si rrethanat rënduese:

Ndërsa Gjykata rrethana rëndese tek i akuzuari nuk gjeti.

Gjykata konsideron se edhe me dënimet e shqiptuara do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 34 të KPK-së, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij dhe të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Trupi gjykues me rastin e matjes se dënimit i ka zbatuar dispozitat e nenit 66 par.1 dhe nenit 67 par.1 nenparagrafi 2 te KPK-se qe ka te beje me zbutjen e dënimit.

IX. LLOGARITJA E MASËS SË ARRESTIT SHTEPIAK

Gjykata ne pajtim me nenin 73 te KPK-se ia ka llogaritur te akuzuarit M.B ne denimin me burgim edhe kohen e kaluar në paraburgim prej dates 31.08.2011 e deri me date 22.11.2011 dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak prej 22.11.2011 deri 22.12.2011.

X. KERKESA PASURORE JURIDIKE

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

XI.KONFISKIMI

Te akuzuarit i konfiskohet mjete I kryerjes se vepres penale-thika.

XII. SHPENZIMET E PROCEDURES

Gjykata ne pajtim me nenin 450 par.1 dhe par.2 te KPP-se e ka obliguar te akuzuarin qe ne emër te shpenzimeve te procedurës penale e ne emër te paushallit gjyqësor ta paguaj shumen prej njëqind (100) Euro dhe shumen prej pesdhjete (50) Euro ne emër te fondit per kompensimin e viktimave.

Në bazë te të dhënave të shënuara me larte u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.48/2011, me datën 13.09.2019

PROCESMBAJTSJA
Qendresa Tahiri

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES
Beqir Halili

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.